



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në me Nenin 14 paragrafi 2.16 dhe Nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.03/L-185;
- Dispozitat e Nenit 24 paragrafi 3 të Rregullit mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, dhe
- Kërkesën për miratimin e “Procedurës së leximit të matësve të energjisë termike / evidencimit të sipërfaqeve të ngrohjes dhe faturimit të konsumatorëve tariforë”, të bërë me datë 11.04.2011 nga ndërmarrja e NQ Gjakova SH.A, adresa: rruga “Tirana”, p.n.-Gjakovë, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 28 prill 2011, nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHET** “Procedura e leximit të matësve të energjisë termike / evidencimit të sipërfaqeve të ngrohjes dhe faturimit të konsumatorëve tariforë” për NQ Gjakova SH.A.

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 11/04/2011 ka pranuar kërkesën e të licencuarit NQ Gjakova SH.A. për miratim të “Procedurës së leximit të matësve të energjisë termike / evidencimit të sipërfaqeve të ngrohjes dhe faturimit të konsumatorëve tariforë”.
- II.** ZRRE pas shqyrtimit të Draft Procedurës së dorëzuar nga NQ Gjakova, ka bërë përmirësimet dhe plotësimet e nevojshme në të, dhe Bordi i ZRRE -së duke u mbështetur në dispozitat ligjore të përmendura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të tij.
- III.** I licencuari obligohet që pas pranimit të këtij vendimi menjëherë ta publikojë këtë Procedurë në faqen e tij elektronike zyrtare.
- IV.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- V.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bashkëngjitur: "Procedura e leximit të matësve të energjisë termike / evidencimit të sipërfaqeve të ngrohjes dhe faturimit të konsumatorëve tariforë".

Bordi i ZRRE-së:

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar